



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Komisioni i Dhënieve të Medaljeve dhe Titujve Vendorë të Nderit

Nr. 2939 prot.

Gramsh, më 24/07 /2025



RAPORT

LËNDA: Për Miratimin e Raportit të Komisionit të Dhënieve të Medaljeve dhe Titujve Vendorë të Nderit.

DREJTUAR: Këshillit Bashkiak Gramsh

BAZA LIGJORE: Ligji 139/2015 për “Vetëqeverisjen Vendore”, Ligji nr.9270/2004 për “Sistemin e Adresave”, Ligji 112/2013 për “Dhënien e Dekoratave, Titujve të Nderit, Medaljet dhe Titujt Vendore të Nderit në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr.109/2018 “Për Statusin e Dëshmorit të Atdheut”, VKM nr.861/2014, Rregullorja e Funksionimit të Këshillit Bashkiak.

Bazuar në thirrjen Nr. 2897 Prot.datë 21/07/2025 drejtuar Komisionit , lidhur me kërkesat drejtuar këtij Komisioni (sipas rendit të ditës përcaktuar në thirrjen bashkëngjitur këtij raport), u mbledh dhe zhvilloi mbledhjen Komisioni , i cili doli me Raportin si më poshtë:

Komisioni Këshillimor për Dhënien e Titujve Vendorë të Nderit i përbërë nga anëtarët: znj.Luljeta Dollani Kryetar, znj.Leidi Shqiponja Anetar, z.Sali Zani Anetar, znj.Alketa Bici, Anëtar ,z.Kodhel,Cala Sekretar i Komisionit,dhe pjesmarrjen e Perfaqesuesit të Shoqates Gore-Opar i cili relatoi propozimet drejtuar Komisionit;u mbledh më datë 24.07.2025 ora 10:00 në sallën e mbledhjeve ku vazhdoi me procedurat e shqyrtimit të propozimeve sipas kriterëve dhe legjislacionit në fuqi.

Në vijim të punës së Komisionit pasi u administrua i gjithë dokumentacioni i kërkuar, u vërejt se propozimet janë në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe kriterëve që ligji përcakton për tu marrë në shqyrtim, (referoju proces-verbalit të mbledhjes së Komisionit i datës 24.07.2025 me nr.2897/1 Prot.), duke i shqyrtuar kërkesë/propozimet në mënyrë individuale për çdo subjekt të paraqitur për vlerësim si pas propozimeve më poshtë:

Mbas kërkesës së bërë nga Shoqata Gorë-Opar e Bashkuar për vendosjen e bustit për atdhetarin ,Komandantin e cetës “Nahije” të Beratit, Sulovës dhe Gramshit, në Njësinë Administrative Tunjë, u administrua dokumentacioni dhe vijua me procedurat sipas ligjitdhe rregullores në fuqi. Kërkesa sëbashku me dokumentacionin u shqyrtua edhe nga administrata e bashkisë paraprakisht ku edhe pas shkresës nga komuniteti i Njësisë , u verifikua që nuk ka konflikt për vendosjen e bustit. Mbaasi u përgatit edhe relacioni nga Drejtoria e Urbanistikës, në Komision shprehim dakortësinë dhe ja propozojmë Këshillit Bashkiak për miratim.

Adresa: Sheshi “Kamber Dermyshe” Bulevardi “10 Korriku”, E-mail:bashkia.gramsh2017@gmail.com

2- Kërkesa tjetër ka të bëjë me emërimin e Qendrës Shëndetësore Njësia Administrative Skënderbegas me emrin e mjekut Baftjar Hoxha.
Edhe për këtë pikë shprehim dakortësinë, le të vendosii Këshilli, gjithashtu zyra e urbanistikës lete na japi konfirmim deri ditën e mbledhjes.

Në përfundim të diskutimeve, komisioni shprehet unanimitisht për dakortësinë e propozimeve të mësipërme, si propozime absolutisht të merituarra për vlerësimin e këtyre figurave.

I propozohet Keshillit ti marri ne shqyrtim ne mbledhjen e ardhshme.

Kryetari i Komisionit

Luljeta Dollani

Sekretari i Komisionit

Kodhel Çala

Anëtar i Komisionit

Leidi Shqiponja

Anëtar i Komisionit

Alketa Bici

Anëtar i Komisionit

Sali Zani